



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 3333 Prot.

Pogradec, më 29 . 08, 2023

VENDIM

Nr. 92 datë 28.08, 2023

PËR MIRATIMIN E TITULLIT  
“ KRENARIA E QYTETIT ”

KRISTAQ KOCI ( PAS VDEKJES )

Këshilli Bashkiak Pogradec në mbledhjen e tij të datës 28.08.2023, me propozim të një grupi artistësh pogradecarë , aprovim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec dhe me miratim nga Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve të nderit, mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 54 germa “m” e tij, ligjit nr. 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr 861 datë 10.02.2014 “ Për miratimin e rregullave të hollësishtme për funksionimin e komisioneve Këshillimore për dhënien e Medaljeve dhe Titujve Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë dhe Rregullores së Bashkisë Pogradec “Për llojet e Titujve të Nderit, Kriteret dhe Proceduren e dhënies së tyre” Neni 5.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së titullit të nderit “ KRENARIA E QYTETIT ”

- KRISTAQ KOCI ( PAS VDEKJES )

Me motivacion: Për kontributin e tij të shquar dhe punën plot pasion për ngritjen e nivelit artistik dhe kulturor në Pogradec, edukimin e brezit të ri me dashurinë ndaj muzikës , traditave dhe folklorit .

2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Këshillimor për dhënien e Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pogradec.

KRYETARË E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

